

Takim në kuadrin e projektit “ QUADIC”

Në Universitetin Teknik më të madh në Bullgari me qendër në Sofje, më 29 mars u zhvillua takimi tre ditor, në kuadër të projektit QUADIC, projekt i financuar nga programi i BE-së Erasmus +. Në këtë takim morën pjesë Universiteti për të huajt I Perugias (Italy), Universiteti I Lubjanës (Slloveni), I Nisës(Francë), universitetet publike të Kosovës dhe disa universitete nga Shqipëria, ku UGJ-së është një nga 18 partnerët e këtij konsorciumi . Një ndër pikat kyçe që u diskutuan në këtë vizitë studimore ishte rritja e kapaciteteve të bashkëpunimit rajonal, nëpërmjet krijimit të platformës së shoqatës “RECON” (Regional Cooperation Network). Partnerët diskutuan dhe sugjeruan mendime dhe ide mbi misionin, vizionin, strukturën dhe rolin e “RECON”.

